



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 10, datë 19.08.2022

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në pallatin e kulturës  
“Labëria “ ( Ora 10<sup>10</sup>)

Marrin pjesë :

- |                    |                      |
|--------------------|----------------------|
| 1.Anxhela Aliraj   | 15.Ardian Skëndaj    |
| 2.Fatos Rukaj      | 16.Briseida Çakëri   |
| 3.Elona Toçaj      | 17.Anisa Shametaj    |
| 4.Ervsi Moçka      | 18.Adiola Gjoka      |
| 5.Arben Meksi      | 19.Grigor Dede       |
| 6.Ramona Jaho      | 20.Kasëm Mahmuti     |
| 7.Brunilda Saliaj  | 21.Gentian Hamzaraj  |
| 8.Jonela Halili    | 22.Edlira Kapllanaj  |
| 9.Asime Feraj      | 23.Rozina Kormuzi    |
| 10.Bujar Osmanaj   | 24.Liljana Breshani  |
| 11.Evis Allushi    | 25.Teki Xhemalaj     |
| 12.Edison Kapaj    | 26.Englantina Imeraj |
| 13.Frosina Qyrdeti | 27.Sulltana Bilbilaj |
| 14.Brunilda Cani   |                      |

Mungojnë :

- 1.Alboren Aliaj
- 2.Ervis Caushaj
- 3.Ina Islamaj

4. Julian Bleta
5. Klara Bajaziti
6. Lindrit Beqiraj
7. Istref Dobi
8. Sulejmën Bubeqi
9. Roneda Muçaj
10. Andi Resulaj
11. Kristaq Meçi
12. Rudi Pashaj
13. Migena Balla
14. Simo Petromilo
15. Klearda Rapushi
16. Sokol Kushta
17. Kreshnik Tepelena
18. Mujo Shakaj
19. Pëllumb Nezha
20. Paula Sullaj
21. Jerina Dervishaj
22. Besian Gega



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 10/1, datë 19.08.2022

Znj.Jonela Halili – Përshëndetje ! Po fillojmë këtë mbledhje të kërkuar nga kryetari i bashkisë, mbledhje jashtë radhe me këtë rend dite. Para se të fillojmë me rendin e ditës , po ju njoh me shprehjen e ligjshmërisë nga prefekti i qarkut Vlorë , ku me shkresat e ardhura, për VKB Nr 51 datë 21.07.2022 është shpallur i ligjshëm dhe, shprehja e ligjshmërisë për VKB e datës 29.07.2022 , Nr 52 ÷ 60 janë të ligjshëm dhe, një ditë më vonë VKB Nr 60 është shpallur i paligjshëm, është anuluar.

Z.Ervis Moçka – VKB Nr 60 , është shpallur i paligjshëm. Na ka ndodhur dhe herë të tjera. Bazuar në ligjin 16 të prefektit të qarkut, pra mund të njihemi me arsyet dhe ta rifusim . Ta ridiskutojmë këtë projekt vendim.

Znj.Jonela Halili - Nëqoftëse doni, ta vendosni këtë pikë në fund të rendit të ditës.

Z.Fatosh Rukaj – Shoh që, prefekti një herë e ka shpall të ligjshëm , një herë të paligjshëm. Prandaj, i bëj thirrje publike prefektit , në lidhje me juristët , me grupin e punës . Në bazë të materialit , mendoj që, nuk qëndron ky pretendim.

Z.Ardian Skëndaj - Nuk qëndron ky pretendim, një herë po, një herë jo i ligjshëm. Në bazë të shkresave nga prefekti , risillet në vëmendje procedura e rishikimit të VKB nr 74.

Kemi marrë vendimin në vitin 2018 , ka qenë i paligjshëm në 1 pikë. Prefekti këtë të ligjshmin e quan të paligjshëm. Nuk e di këtë apriori. Kam bërë një shkresë , një argumentim teknik , do ti'a bëj të ditur këshilltarëve.

Znj.Jonela Halili- Le ti japim hapsirën e duhur rendit të ditës dhe në fund e shqyrtojmë. Atëherë , kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 21 korrik 2022 dhe datë 29 korrik 2022.

Materiali ju ka ardhur dhe me e-mail. Nëqoftëse s'ka gjë , e hedhim në votim.

Votohet.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro , të gjithë – 27 vota.

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 10/2, datë 19.08.2022

Znj.Jonela Halili – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr 80, datë 02.12.2021 “Mbi përcaktimin e orarit në të cilin subjektet private do të depozitojnë mbetjet e tyre në kontenierët e mbetjeve urbane “.

Nga administrata?

Znj.Sonela Haxhiraj – Me anë të këtij materiali , vendosim orarin e derdhjes së mbetjeve. Në mbledhjet e komisioneve , u vendos të ndryshojë , pika 1 dhe pika 2 e projekt vendimit të bëhet në një pikë të vetme. Lexon...Të shtohet pika “r” me këtë përmbajtje. Pra, orari nga ora 22.00 ÷24.00.

Znj.Jonela Halili – Diçka të përmbledhur .

Znj.Sonela Haxhiraj - Për shkak të një ngërçi në lidhje me pastrimin, në takimin që bëmë me prefektin ku ishte dhe përfaqësuesi i firmës , u la si pretekst , orari nga ana e tij për derdhjen e mbetjeve.

Kjo do të pasqyrohet në VKB.(lexon ....)...të shtohet pika 1 ....., mosrespektimi...i orarit 22.00÷ 24.00. Pra, të gjitha subjektet , do të depozitojnë mbetjet në këtë orar. Kush nuk i depoziton në këtë orar , do të ketë sanksione.

Z.Ervis Moçka - Me aktivitet privat, çdo të thotë?

Znj.Sonela Haxhiraj - Për pjesën e bizneseve, bizneset.

Z.Ervis Moçka – Pashë orarin 22.00÷23.00.

Znj.Sonela Haxhiraj - Do të ndryshojë, do bëhet 22.00÷24.00.

Z.Ervis Moçka - Flas për disa biznese të mëdha, operatorë të mëdhenj që nuk mund ti heqin vetëm 1 herë në ditë mbetjet, mbase 2 herë. Ndonjë diskutim me ta ?

Dëgjova që ka patur takim me prefektin...Afekton .., në lidhje me kontartën ..

Znj.Sonela Haxhiraj - Për disa subjekte , për heqjen e mbetjeve jo vetëm 1 herë , do të diskutohet me këto biznese dhe firmën dhe, do vendosim ....Në kontratë , heqja e mbetjeve është nga ora 22.00÷06.00 të mëngjesit. I përfshin oraret.

Z.Kasëm Mahmuti – U ezauruan 2 çështjet nga zoti Ervis.Pra, ndryshimi i orarit nga 22.00÷24.00. Subjektet që kërkojnë 2 herë në ditë depozitimin e mbetjeve. Firma e pastrimit, i bën 2 herë këto qeqje ? Pastrimi që bëhet 2 herë në ditë, është “nul”.

Gjej momentin dhe operatorët turistikë nuk mund të zbatojnë një projekt vendim me gjoba . Është për të gjithë qytetarët, për imazh.

Znj.Jonela Halili – Pyetje të tjera ?

Znj.Liljana Breshani – Më vjen shumë çudi që jemi në fund të mujait gusht dhe, vendosim tani për orarin e heqjes së mbetjeve. Përveç këtyre janë dhe biznese, hoteleri që jepen me buking. Është një rrëmuje shumë e madhe. Nuk ka kosha. Kjo, mendoj se, po bëhet më shumë për pikën 2, për gjobat.

Znj.Jonela Halili – Orari i heqjes së mbetjeve 22.00÷24.00 dhe aktiviteti tregëtar , jo privat. E hedhim në votim me këto ndryshime .

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro, të gjithë -27 vota.

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 10/3, datë 19.08.2022

Znj.Jonela Halili - Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “ Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 84, datë 16.12.2021, lënë në fuqi me VKB-në Nr 4, datë 31.01.2022 “Për buxhetin e Bashkisë për vitin 2022”, i ndryshuar me VKB-në Nr 24, datë 28.03.2022 “ Nga administrata?

Z.Daut Zëraj - Ky projekt vendim ka lindur si domosdoshmëri nga kërkesa të sektorëve të ndryshëm. Tek ky projekt vendim, pika 4”a”, mbasi jemi konsultuar dhe me anëtarë të komisionit , kemi shtuar mbas pikës 5 , pikën 6 (lexon )...Të hiqet 1.5 milion lekë dhe 18.5 milion lekë për rikonstruksionin e shkollave.

Për këtë po bëj sqarim. Në VKB NR 84/2021 “Për buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2022 “. (lexon....18.5 milion lekë të përdoren për fonde emergjente për rikonstruksion të shkollave “Lef Sallata”, “15 Tetori” dhe “Avni Rustemi “. Këto fonde, mos të ngelen, por ti përdorim.

Të shtohet pika 6 me këtë formulim që thashë .Pikat e tjera, siç janë sqaruar në relacion.

-Shuma prej 8 milion lekë , që ka qenë për skrep, të merret një bot për larje apo ujitje.

-Nga agjencia kombëtare e mbrojtjes civile , shuma prej 33.789 ...mijë lekë, për emergjencat civile . Nga fondi i mësipërm, për 60% -in, mund të vendosë këshilli bashkiak . Nga kjo 2.5 milion lekë ta përdorim për të ngritur një mur nga shkarjet e dherave., në rajonin 5.

-Shumën tjetër prej 3 milion lekë , për përbalimin e mjeteve zjarfikëse, uniforma për MSZH.

-Nisur nga kërkesa e Klubit Shumësportësh “Flamurtari “, është parashikuar fondi prej 10 milion lekë për çatinë e shumësportëshit. Ky fond , është i pamjaftueshëm dhe, të kalojë për rikonstruksionin e palestrave .

-Është dhe një propozim tjetër, për mbarështimin e kullotave . Do bëhet me subjekt të licensuar ky shërbim dhe, të realizohet me të ardhurat e veta, pa prekur buxhetin e bashkisë. Këto janë .

Znj.Jonela Halili - Pyetje nga këshilltarë?

Z.Edison Kapaj - Rikonstruksioni i shkollave në qytet , por në fshatra, asnjë. Do të thoja për shkollën në Kërkovë . Është në gjendje të mjerueshme. Doja të përfshihej në investime.

Z.Ardian Skëndaj - Të njëjtën gjë do të thosha. Jo vetëm këto tre shkolla. Duhet një studim më i plotë . Ka më shumë shkolla që kanë nevojë për rikonstruksion.

-Pika “ç”, do të doja një akt inspektimi në Rajonin nr 5 , përgatitje më të saktë. E kemi kaluar dhe nuk e kemi bërë. Sillni një akt inspektimi.

Ke fondin 18.5 milion lekë të shkollave. I kalojmë në mbledhjen tjetër këto dy pika . Them ta votojmë , të heqim këtë 18.5 milion dhe 2.5 milion për shkarjen e dherave. Pse s’qenka bërë, na jepni sqarim.

Z.Daut Zëraj - Po e sqaroj. Këshilli bashkiak në vitin 2021 e ka quajtur emergjente . S’ka patur fond.

Z.Ardian Skëndaj - S’është i saktë.

Z.Daut Zëraj - Me këtë shumë 18.5 milion, s’mund të bëhen të gjitha shkollat.

Z.Ardian Skëndaj - Them ta votojmë , pa 18.5 milion të shkollave dhe 2.5 milion lekë të shkarjes së dherave.

Znj.Jonela Halili - Meqenëse mbledhja e radhës do të jetë në vazhdim , le të përgatitet një material në lidhje me gjendjen e shkollave në qytet dhe fshatra.

Z.Zambak Selmani - Ky është me investime, me bashkëfinancim nga qeveria . Për këtë shumë përcaktojmë shkollat, 18.5 milion-shin miratoni.

Z.Kasëm Mahmuti – Dua të jem i qartë.Tek fondi në pikën 3 “b”, fondi si është përcaktuar ?

Z.Daut Zëraj – Në varësi të nevojave .

Z.Kasëm Mahmuti - Ka shërbime bazë, jo apriori.

Z.Daut Zëraj – Tani na erdhi fondi .

Z.Kasëm Mahmuti – Ky fond, do rishikuar dhe rritur për shërbimin e zjarrfikëses. Është pak 3 milion lekë të reja.

Z.Kasëm Mahmuti – E dyta. Jam dakort.E vlerësoj pyetjen e zotit Ardian , duhet parë pika “ç”, këtë rrëshqitjen e dherave. Është shumë problematike. Pse , s’është bërë ?

-Fonde për veshjet zjarrduruese për punën në Repartin e Mbrojtjes nga Zjarri .

Për të konkluduar:

Të shihet fondi prej 3 milion lekë/reja dhe 25 milion lekë /vjetra , të kalojnë se s’bën në mbledhjen e radhës.

Z.Fatos Rukaj – Pika 4”a”; shuma 9 milion lekë/reja, pse është hequr. Nuk më duket lapsus gjithë kjo shumë . Ura që lidh fshatrat , në njësinë e Shushicës , është nga më të varfërat kjo zonë. I shërben shumë zonës. Duhet një shumë e vogël për urën.

Z.Daut Zëraj – Lëvizja e fondeve ...

Znj.Jonela Halili - Për procedurë. Jemi dhe pa sekretar këshilli që shikon pjesën ligjore, duhet dhe pjesëmarrja e Kryetarit të bashkisë në mbledhjet për buxhetin.

Znj.Jonela Halili – Tek pika 4 , është hequr pika “a” dhe pika “ç”. Drejtori relatoi. Pra, në votim pa pikën 6 . Pra pika 6 qëndron, por hiqet shuma ...?

Z.Kasëm Mahmuti – Meqenëse ka shumë kërkesa le të ripunohet dhe të silllet herën tjetër.



Znj.Jonela Halili – Pra, e hedhim në votim. Tek pika 4 , hiqet “a” dhe “ç”. Tek pika 6, hiqet “b”.Do kalojnë për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Z.Kasëm Mahmuti – Bëra dhe unë propozim.

Znj.Jonela Halili – Kalojmë në votim me këto ndryshime ?

Votohet.

Pro të gjithë – 27 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 10/4, datë 19.08.2022

Znj.Jonela Halili – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për miratimin e tavanëve përgatitorë për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023 – 2025”.

Nga administrata ?

Z.Daut Zëraj – Mbledhjen e kaluar këshilli miratoi PBA. Mbi bazën e treguesve të buxhetit afatmesëm , kanë dalë dhe tavanët përgatitorë . Në bazë të këtyre , PBA 2023 ÷2025, do të nisë puna për buxhetin afatmesëm , që do të kalojë brenda datës 15 shtator. Do të punojnë gjithë drejtoritë. Do të bëhen dhe dëgjesat publike. Shifrat janë të njëjtë me ato të PBA.

Z.Grigor Dede - Në lidhje me furnizimin me ujë dhe kanalizimet, nuk e kuptoj.Kur miratohet të hiqet kjo pikë.

-Fondi për menaxhimin e mbetjeve..

-Të shtohet neni 32 dhe, a është marrë parasysh ...

Z.Ervis Moçka – Kemi tavanët

Znj.Jonela Halili - Nëqoftëse, nuk ka pyetje , e hedhim në votim. Votohet.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro , të gjithë – 27 vota.

Miratohet .



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 10/5, datë 19.08.2022

Znj.Jonela Halili – Këtu kemi përfunduar me pikat e rendit të ditës.

Me Kërkesën e kryetarit të grupit socialist , në lidhje me shprehjen , jo të ligjshëm të VKB Nr 60 datë 29.07.2022. Nga administrata?

Duhet të reagojë administrata . Nuk është plani vendor veprimi, në lidhje me këtë vendim .

Z.Daut Zëraj – Ky lindi tani si diskutim dhe mendoj ta sjellim në mbledhjen e radhës. Nuk mund të shprehem sot. Ne në mbledhjen e radhës do të vijmë me projekt vendim.

Znj.Jonela Halili – Këto konstatime , a qëndrojnë ?

Z.Ardian Skëndaj - Është në fuqi një vendim këshilli i vitit 2018 . Ne e kemi kthyer zhurmën në normalitet. Ka qenë orari deri në 4 të mëngjesit. Ju kishit VKB Nr 74 datë 17.07.2018. Ne gjeneruam zhurmat.

Z.Daut Zëraj - Duam të punojmë, të kemi kundërargumentat .

Z.Zambak Selmani - Ky ka ardhur nga prefekti.

Z.Ervis Moçka - Një përmbledhje të vogël. Administrata e njej shumë mirë shprehjen e ligjshmërisë . Këshilltarëve nuk ju ka vajtur.

Prefekti thotë, meqë nuk ka një plan vendor veprimi (lexon....), VKB nr 60 ....Pra, këshilli në vitin 2018 ka marrë një vendim. Indicia ka qenë nga prefekti, me një shkresë në muajin shkurt a mars ..Pra, administrata i ka shkruajtur një përgjigje zotit prefekt. Në vitin 2018 , ka një pikë të paligjshme dhe me këtë, prefekti e ka sjellë të ligjshëm , që ishte në kundërshtim me VKM.

U bë një hartëzim i zonave , sipas aktiviteteve, është miratuar.

Pra, bazuar në këtë vkb, prefekti shpall të paligjshëm një gjë të ligjshme , ndërkohë që vkb e vitit 2018 , bie e ndesh me VKM.

Neni 8, ligjit 107/2016 dhe në vitin 2018 nuk kishte plan .Pse atëherë nuk e ngriti këtë argument ?

Pra, është një detyrim i organit të pushtetit vendor , nuk është nen , që , në mungesë të atij plani,...plani nuk është vetëm për muzikën . Pra, sipas llogjikës së prefektit që nuk ka plan veprimi.....Pra, sipas nenit 8,të ligjit 9774/2007 , pika 2 këshilli...,plani miratohet nga këshilli bashkiak. Po të marrim një vendim bazuar në VKB Nr 60 datë 29.07.2022...Për mua bien të gjitha pretendimet . Në bazë të Ligjit Nr 16 “Për Prefektin “, ne sot po rishikojmë aktin tonë. Z.Grigor Dede - Ky arsyetim është shumë i arsyeshem. Ky projekt vendim kishte disa problematika , ky bazohet në VKM. Pra, s’është në rregull VKM –ja?

Znj.Jonela Halili – Pra, e hedhim në votim VKB Nr 60?

Votohet.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro , të gjithë – 27 vota.

Miratohet.

Z.Ardian Skëndaj – Kisha diçka, në lidhje me vendimet që marrim.

Brenda bashkisë nuk zbatohen vendimmarrjet.

-Kërkoj nga ju drejtoresha e DAV , informacion mbi detyrimet e kazinove dhe,

-Drejtoresha Juridike , një kopje të kontratës së firmës së pastrimit me bashkinë . Për mbledhjen e ardhshme këto si dhe, dua situacionet për 3 vitet e fundit, ku ka pas rrugë në rikonstruksion etj... Si ka qenë situata, pagesat.

Znj.Jonela Halili – Faleminderit, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbajti Procesverbalin

Zhaneta Gjika



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 11, datë 01.09.2022

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në pallatin e kulturës  
“Labëria “ ( Ora 10<sup>10</sup>)

Marrin pjesë :

- |                     |                      |
|---------------------|----------------------|
| 1.Edlira Kapllanaj  | 15.Arben Meksi       |
| 2.Simo Petromilo    | 16.Asime Feraj       |
| 3.Ramona Jaho       | 17.Rozina Kormuzi    |
| 4.Sokol Kushta      | 18.Istref Dobi       |
| 5.Ardian Skëndaj    | 19.Jonela Halili     |
| 6.Edison Kapaj      | 20.Kristaq Meçi      |
| 7.Ervis Moçka       | 21.Adiola Gjoka      |
| 8.Kasëm Mahmuti     | 22.Englantina Imeraj |
| 9.Pëllumb Nezha     | 23.Grigor Dede       |
| 10.Migena Balla     | 24.Kreshnik Tepelena |
| 11.Klara Bajaziti   | 25.Brunilda Saliaj   |
| 12.Frosina Qyrdeti  | 26.Ina Islamaj       |
| 13.Liljana Breshani | 27.Fatos Rukaj       |
| 14.Gentian Hamzaraj |                      |

Mungojnë :

- 1.Klearda Rapushi
- 2.Alboren Aliaj
- 3.Ervis Caushaj

- 4.Briseida Çakërri
- 5.Julian Bleta
- 6.Lindrit Beqiraj
- 7.Elona Toçaj
- 8.Sulltana Bilbilaj
- 9.Sulejmën Bubeqi
- 10.Roneda Muçaj
- 11.Andi Resulaj
- 12.Rudi Pashaj
- 13.Bujar Osmanaj
- 14.Besian Gega
- 15.Anxhela Aliraj
- 16.Paula Sullaj
- 17.Evis Allushi
- 18.Jerina Dervishaj
- 19.Brunilda Cani
- 20.Teki Xhemalaj
- 21.Mujo Shakaj
- 22.Anisa Shametaj



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 11/1, datë 01.09.2022

Znj.Migena Balla – Përshëndetje! Uroj të keni kaluar pushime të gëzuara si dhe ju uroj sezon të mbarë. Jeni njohur me materialet e rendit të ditës . Kemi 3 pika . Përsa i përket shprehjes së ligjshmërisë, nuk kemi .

Vazhdojmë me votimin e rendit të ditës .

Votohet.

Pro – të gjithë, 27 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Z.Ardian Skëndaj - Sot kemi shtuar një projekt vendim në rendin e ditës me kërkesën e një grupi qytetarësh dhe propozim të këshilltarëve , për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Vlorë, me emrin e Doktorit “Leonard Kamberaj”. Mendoj ta fusim në rendin e ditës.

Znj.Migena Balla – Atëherë, kalojmë dhe një herë në votim rendin e ditës me projekt vendimin shtesë.

Pro – të gjithë, 27 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet rendi i ditës.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 11/2, datë 01.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin korrik 2022”. Nga administrata një relacion ?

Znj.Irena Stasa - Përshëndetje! Edhe për këtë muaj , nga të ardhurat e bashkisë , do të trajtohen 37 familje me fondin e përcaktuar. Një familje më shumë se herën e kaluar , është i sëmurë mendor , me probleme social ekonomike. Pra, përfitojnë 37 familje.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? – S’ka .

Votohet.

Pro – 27 vota.

Kundër -0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet .





---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 11/3, datë 01.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit  
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin korrik 2022”.  
Nga administrata një relacion ?

Znj.Irena Stasa - Edhe këtë herë , për arsye se nuk ka punuar sistemi , janë 16 familje përfituese nga fondi i kushtëzuar.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? – Jo.

Kalojmë në votim.

Pro - të gjithë , 27 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 11/4, datë 01.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “ Për një ndryshim në VKB Nr 21 datë 28.03.2022 “Për shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “. Nga administrata ?

Z.Adrian Vreshtazi - Kemi kaluar VKB Nr 21 datë 28.03.2022, për një ndryshim në këtë vendim bëhet fjalë, ku vlera financiare nga zoti Ilirjan Skëndaj, do kalojë për zotin Odisea Mano. Autorizoi zotin Ilirjan , pasi nuk vinte dot, ishte sëmurë . E kërkojmë ndryshimin, mos të krijohet situatë tragjike.

Znj.Frosina Qyrdeti – Kur kemi marrë vendimin , pse nuk e kemi marrë në emrin e Odisea Mano-s.

Z.Adrian Vreshtazi – Që me kërkesën e bërë , që ai, kishte autorizuar personin në fjalë , zotin Ilirjan . Është shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Znj.Frosina Qyrdeti – Këtu vjen një dokument i thjeshtë . Të kuptohet e kujt është banesa dhe cili duhet ta marrë vlerën financiare.

Z.Adrian Vreshtazi –Në projekt vendim, në muajin mars, është i gjithë dokumentacioni në dosje , të gjitha kërkesat, çertifikata etj. Nëqoftëse nuk do aplikonte s’kapte afatet.

Znj.Frosina Qyrdeti – Kur ne nuk shohim letrat bashkëlidhur.

Z.Adrian Vreshtazi - Ne kemi dokumentacionin bashkëlidhur, i kemi në dosje. Shuma i është bllokuar zotit Ilirjan Skëndaj dhe do ta marrë zoti Odisea Mano .

Znj.Frosina Qyrdeti – Herë tjetër më të vëmendshëm.

Znj.Migena Balla – Nëqoftëse, s’ka pyetje , diskutime ? -Jo.

Kalojmë në votim. Votohet.

Kundër – 1 votë (Znj.Liljana Breshani - jam e paqartë ).

Abstenim – 0 votë.

Pro – 26 vota.

Miratohet.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 11/5, datë 01.09.2022

Znj.Migena Balla –Kalojmë në pikën 4, shtesë, të propozuar nga zoti Ardian Skëndaj në lidhje me emërtimin e rrugës pranë Kishës Ortodokse , me emrin e doktorit z.Leonard Kamberi, në projekt vendimin “ Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Vlorë” me emrin e Doktorit “Leonard Kamberi “.

Pyetje , diskutime ? E hedhim në votim?

Po lexoj relacionin. (Lexon )... ku me kërkesë të një grupi qytetarësh dhe propozim të këshilltarëve , ...mbi arsimin, detyrën dhe jetën e doktorit, zotit Leonard Kamberi , punën e bërë gjatë viteve si mjek , bëjnë këtë propozim.

Z.Daut Zëraj – Për procedurë. Është parë me drejtorinë e Urbanistikës , mos ka mbivendosje.

Z.Ardian Skëndaj – Është rruga me dy fraksione. Do ndahet. Është rruga “Jeronim De Rada “ dhe “Leonard Kamberi “.

Znj.Migena Balla – Ndonjë pyetje, diskutim ? - Jo.

Votohet.

Pro – të gjithë, 27 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 11/6, datë 01.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë tek pika “Të ndryshme “.

Z.Sokol Kushta - Në lidhje me pastrimin do të diskutoja. Problemi midis firmës së pastrimit dhe bashkisë. Do të kërkoja mbledhjen tjetër , ballafaqim , çfarë ndodh ? Shikojmë në FB , makinat që bëjnë pastrimin. Duhet ti themi faleminderit qeverisë në lidhje me makinat gjermane të pastrimit. Dua të vijë dhe Firma “Duka “ dhe nga bashkia kush merret me pastrimin, në interperlancë. Kemi dhënë fonde për pastrimin.

Z.Fatos Rukaj – Kisha 2 problematika :

1-Në Njësinë Shushicë , janë dhenë liçencat e transportit midis qendrave dhe qytetit . ka shumë të papunë në atë zonë . Ka që punojnë dhe në fasoneri, ndërtim ,sigurimin e transportit, kush e bën? Do të thosha në lidhje me orarin e furgonave tek stacioni , oraret e vona mungojnë .

-Parkimi, linjat . Kur është bërë inspektimi i fundit i liçencave , informacion , për mbledhjen e radhës.

2-Në fshatin Grabjan , emergjente, ujrat e zeza janë në sipërfaqe. Rrezik për përhapjen e epidemisë.

Z.Zambak Selmani – Në lidhje me furgonat , tek “Sazani “ vetëm Babica dhe Llakatundi janë, të tjerët tek “Rruga e Re “.

-Pjesën e orareve do ta shohim. Është stacion, jo parkim.

Z.Fatos Rukaj - Kur është monitoruar . Tani jam informuar , kam qenë unë , është dhe ankesë e qytetarëve.

Znj.Migena Balla – Keni kërkesë tjetër ?

Z.Fatos Rukaj - Ujrat e zeza në sipërfaqe . Është prag epidemie , në fshatin Grabjan.

Z.Edison Kapaj - Dëgjova zotin Sokol, në lidhje me pastrimin . Më vjen mirë që bashkia është angazhuar, po punon, por njësitë janë lënë pas dore. Duhet të mirëmbahen kanalet, shkollat. Doja të dija në lidhje me punonjësit e njërive që lëvizin, kush i mbulon këto kosto të udhëtimit. A venë të gjithë punëtorët në punë ?

-Në lidhje me ujësjellësin e Novoselës , punimet vazhdojnë. Rruga mos të çahet përsëri, në aksin Vlorë-Fier.

-Ekualipset janë tharë. Me ardhjen e vjeshtës , pemët bien në rrugë.

Z. Kanan Shakaj – Punëtorët merren me furgon. Ka dalë një urdhër i kryetarit të bashkisë . Punëtorët do ta bëjnë 10 ditë, është aksion. Në lidhje me ujësjellësin, i ka kaluar një firmë tjetër. Kam njoftuar ministrinë. Është problem shqetësues.

Z.Edison Kapaj - Për njësinë Qendër, punëtorët s'kanë pse e paguajnë vetë.

Znj.Edlira Kapllanaj – Edhe unë , si përfaqësuese e dy komuniteteve , bashkë me Rozinën,do të diskutoja në lidhje me vështirësitë që kalon rinia sot , shqetësim për zyrën e BE në Bashkinë Vlorë. BE ka një vëmendje të veçantë në lidhje me të rinjtë e këtyre dy komuniteteve. Kam kërkuar statistika. Të bëhen fushata, nisma.

-Sa të rinj , janë aktivizuar ? A ka një plan strategjik për aktivizimin e këtyre të rinjve , Nuk kemi parë asnjë bashkëpunim.

-Është lënë projekti përgjysmë ....Komuniteti ynë ka nxjerrë shumë mjek, juristë, nuk janë vetëm të “vobektë”. Kërkojmë bashkëpunim, që dhe ata, të studiojnë . Kjo zyrë, e BE , nuk ka qenë bashkëpunuese . Kemi lënë një anëtar të Bordit të Këshillit Rinor . E kërkoj vetë që të vetëkandidoj.

Znj.Englantina Imeraj – Vlora, ku ka shumë potenciale. Për shumë prioritetë që qeveria i jep qytetit tonë, ne duhet të kemi turizëm gjithëvjetor. Në lidhje me pastrimin , po punohet. Kemi bërë shumë investigime , Vlora, të paktën, zona të caktuara janë ende pa pastruar , si kanali i “Naunkës”, zona mbas pallateve në Lungomare . Të gjithë si qytetarë , apo dhe si këshilltarë , ne nuk na intereson situata firmë – bashki . Ne e duam qytetin të pastër., ose siç themi “ti vihet gishti kokës “. Duhet të reflektojmë të gjithë dhe kryetari i bashkisë, duhet të jetë në mbledhje dhe përballë qytetarëve dhe këshilltarëve . Të jetë në interperlancë në lidhje me pastrimin dhe firma e pastrimit.

Z.Ardian Skëndaj – Si gjithmonë vazhdojnë mungojnë drejtorët , herë vijnë ca dhe, herë ca të tjerë mungojnë .

Znj.Aulona Veizi – Janë të gjithë.

Z.Ardian Skëndaj – Kush nuk mund të bëjë punën , le të ikë.

-Kam kërkuar organigramën e 3 institucioneve.

-Policia bashkiake , të paraqesë plan pune për muajin shtator, të detajuar. Kemi kërkesa nga drejtorët e bashkisë. Dua përgjigje të sakta , jo evazive, të detajuara.

-Në Lungomare, ka kaq kohë që uji rrjedh dhe shkon kot . Asnjë reagim . Vetëm foto . Kam një sërë pyetjesh të përgatitura. Dua përgjigjen brenda afatit ligjor. Përgjigje të sakta , jo evazive. Zonja nënkryetare , s'ke bërë gjithë paraqitjen e drejtorëve të institucioneve.

Znj.Aulona Veizi - Ata që mungojnë , janë me arsye.

Z.Ardian Skëndaj - Jemi si grup socialist në” luftë” në lidhje me qytetin, për problematikat dhe për të mirën e qytetit.

Znj.Liljana Breshani – Zoti Ardian , ka shumë të drejtë në lidhje me prezencën e drejtorëve, sikurse dhe drejtorin e Veterinarisë. Kam bërë shumë kërkesa në lidhje me Drejtorinë e Veterinarisë dhe, dua të di çfarë bëhet në lidhje me kafshët e rrugës . Dua një relacion . Kemi shumë të huaj në qytet. Është aprovuar një fond në buxhet. Nuk di çfarë po bëhet me këtë fond. Të lutem zonja kryetare, dua një përfaqësues nga drejtoria e veterinarisë . Si po zbatohet Ligji i Veterinarinë . Çfarë po bëhet dhe, me problematikat e kafshëve në situatë rruge ?

Z.Ardian Skëndaj - Në emër të grupit , do të ngrihet një komision për monitorimin e punës, aktivitetit të drejtorive, institucioneve të bashkisë.

Znj.Migena Balla – Ndonjë pyetje, diskutim tjetër ? - Jo.

Atëherë , mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit.

Mbajti Procesverbalin

Zhaneta Gjika